



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

VENDIM

Nr. 19 datë 19.03.2021

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TESTIMIT PËR PËRMBUSHJEN E
ORËVE TË EDUKIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL PËR KONTABILISTËT E
MIRATUAR PËR PERIUDHËN 2014-2019**

Ky Vendim është hartuar në bazë të përcaktimeve në pikën 1, gërma dh) dhe h) të nenit 5, pikën 1, pikën 5, pikën 6, pikën 7 dhe pikën 8 të nenit 25, si dhe nenit 52 të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe përcaktimet e pikës 1, pikës 6, pikës 7 dhe pikës 11 të nenit 4 dhe pikës 29 të nenit 12 të Rregullores nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, e ndryshuar.

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim monitorimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të testimit të edukimit të vijueshëm (KVP) sipas moduleve përkatëse profesionale të detyrueshme për Kontabilistët e Miratuar të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën 2014-2019.

Në këtë vendim parashikohen:

- a. Rregulla të përgjithshme lidhur me modulet e përfshira në programin e testimit, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat e përfshirë në procesin e testimit të edukimit të vijueshëm;
- b. Organizimi i procedurave të testimit nga Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar dhe monitorimi nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, përmes një sekretariati ad-hoc të përbërë nga Struktura Mbështetëse dhe ekspertë të jashtëm, sipas parashikimeve të nenit 4 të këtij vendimi.

Neni 2

Subjektet

Subjekte të këtij Vendimi janë: Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Sekretariati Mbikëqyrës, Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar dhe Kontabilistët e Miratuar të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën kohore 2014-2019.

Neni 3

Organizimi i Procesit të Testimit të Edukimit të Vijueshëm

1. Organizatat Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar organizojnë procesin e testeve për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional për Kontabilistët e Miratuar. Procesi përfshin: procedurat e hapjes së procesit të testimit për KVP, regjistrimin e Kontabilistëve të Miratuar për të hyrë në procesin e testimit për KVP, hartimin e moduleve të testimit për KVP, procedurat e testimit për KVP, procedurat e hartimit dhe korrigjimit të tezave për KVP, procedurat

e shpalljes së testimit për KVP, nxjerrjen e rezultateve të testimit dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare pas ankimit. I gjithë ky proces mbikëqyret nga Sekretariati Mbikëqyrës dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka të drejtë që, me propozimin e Sekretariatit Mbikëqyrës, Organizatave Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar, anëtarëve të BMP-së, apo ankesave të KM, të shqyrtojë pajtueshmërinë ligjore dhe pajtueshmërinë me kuadrin rregullator të këtyre procedurave dhe të ndryshojë ato në rast se është e nevojshme.

Neni 4

Organizimi i Sekretariatit Mbikëqyrës

Për të realizuar mbikëqyrjen, monitorimin dhe zbatimin e procesit të testimit të KVP në përputhje me kuadrin rregullator, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP), ngrihet dhe funksionon Sekretariati Mbikëqyrës (SMKVP), e cila do të jetë struktura që do të mbikëqyrë procesin e organizimit dhe funksionimit të testimit sipas moduleve përkatëse në përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional për Kontabilistët e Miratuar.

1. Sekretariati Mbikëqyrës përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Drejtori Ekzekutiv i BMP-së, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a. dy anëtarë nga Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (personeli i përhershëm ose komisionet e ngritura pranë tij);
 - b. një anëtar nga Institucionet e Arsimit të Lartë;
 - c. dy ekspertë të jashtëm të fushës.
2. Anëtarët e Sekretariatit Mbikëqyrës duhet:
 - a. të kenë shtetësi shqiptare;
 - b. të kenë integritet moral dhe profesional;
 - c. të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
 - d. të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin "Master" ose të zotërojnë një diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar ose të kenë ekspertizë në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën.
3. Përfaqësuesit e parashikuar në gjurmën b) dhe c) të pikës 1 të këtij neni aplikojnë drejtpërdrejtë pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Njoftimi bëhet përmes njoftimit ose publikimit në faqen zyrtare të internetit të BMP-së. Procesi i vlerësimit të kandidatëve realizohet nga Struktura Mbështetëse e BMP-së, e cila bën vlerësimin e aplikimeve duke konsideruar kriteret e përcaktuara në këtë nen dhe ia paraqet Drejtorit Ekzekutiv për vendimmarrje. Përmes një procesi vlerësimi të dosjes së kandidatëve për t'u përzgjedhur si anëtarë të Sekretariatit Mbikëqyrës, Drejtori Ekzekutiv përzgjedh dhe emëron kandidatët fitues.
4. Programi dhe kalendari i punës së SMKVP propozohet nga ky i fundit dhe miratohet nga Drejtori Ekzekutiv i BMP-së.
5. Honoraret e SMKVP përcaktohen në përputhje me dispozitat e nenit 16, pika 2, të rregullores nr. 5, datë 29.03.2018 "*Për Organizimin dhe funksionimin e strukturës mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike*", e ndryshuar.

Neni 5

Organizata Profesionale

1. Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar organizon procesin e testimit për përmbushjen e orëve të edukimit të vijueshëm profesional për Kontabilistët e Miratuar, sipas

akteve nënligjore të funksionimit për: procedurat e hapjes së procesit të testimit për KVP, regjistrimin e Kontabilistëve të Miratuar për të hyrë në procesin e testimit për KVP, hartimin e moduleve të testimit për KVP, procedurat e testimit për KVP, procedurat e hartimit dhe korrigjimit të tezave, procedurat e shpalljes së testimit për KVP, nxjerrjen e rezultateve të testimit dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare pas ankimit.

2. Datat e testimit shpallen të paktën një muaj përpara se kandidatët të hyjnë në procesin e testimit.
3. Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar administron listën e të gjithë Kontabilistëve të Miratuar anëtarë të saj, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e edukimit të vijueshëm profesional për periudhën kohore 2014-2019, shoqëruar me informacion në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, të cilin ja vë në dispozicion Sekretariatit Mbikëqyrës.

Neni 6

Modulet e Programit të Testimit

1. Programi i testimit përbëhet nga dy Module. Çdo Modul përmban temat dhe nëndarjet për çdo temë, ku përfshihen kryesisht njohuritë bazë, si më poshtë:
 - **Moduli I** do të përfshijë njohuri të përgjithshme dhe specifike për Ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, çështje të lidhura me analizën financiare dhe dallimet ndërmjet dy raportimeve, çështje të lidhura me ligjin për auditimin në masën që prek kontabilistët e miratuar, si dhe njohuri të përgjithshme për ndryshimet në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.
 - **Moduli II** do të përfshijë njohuri të përgjithshme dhe specifike për ndryshimet në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, njohuri të përgjithshme dhe specifike për ligje të ndryshme, të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me domosdoshmërinë e njohurive që duhet të ketë një Kontabilist i Miratuar për të ushtruar profesionin e tij sipas kërkesave të ligjit, si dhe ndryshimet ligjore në ligjet e mësipërme dhe në legjislacionin që lidhet me profesionin e Kontabilistit (*Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; Ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit; legjislacioni lidhur me tatimet dhe taksat, kontabilitetin e drejtimit, etj.*)
2. Përmbajtja dhe përditësimi i Moduleve miratohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, sipas propozimit të Organizatës Profesionale të Kontabilistëve të Miratuar.

Neni 7

Zhvillimi i Testimeve të kualifikimit të vijueshëm profesional

1. Testimi për Modulet e përcaktuara në nenin 6 të këtij vendimi organizohet dhe zhvillohet nga Organizata Profesionale, nën monitorimin dhe mbikëqyrjen e Sekretariatit Mbikëqyrës të BMP-së.
2. Organizata Profesionale vë në dispozicion të SMKVP-së çdo informacion që lidhet me këtë proces dhe krijon kushtet që SMKVP të jetë pjesëmarrëse në çdo proces të lidhur me testimin e KVP, nëse gjykohet e nevojshme nga kjo e fundit gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
3. Kontabilistët e Miratuar do t'i nënshtrohen testimit për edukimin e vijueshëm sipas Moduleve të cilat kategorizohen në fashat si më poshtë:
 - a. 0-100 orë edukimi të vijueshëm të papërmbushura do të zhvillohet testim me modulin I;
 - b. 101-200 orë edukimi të vijueshëm të papërmbushura do të zhvillohet testim për të dy modulet (modulin I dhe II);

- c. subjektit KM mund ti njihen 50 orë, në rast se provon në mënyrë të dokumentuar pranë Organizatës Profesionale përmbushjen e njëres prej pikave në vijim:
- në 3 vitet e fundit ka punuar së paku për 1 vit në hartimin e pasqyrave financiare, mbajtjen dhe përgatitjen e librave kontabël, fiskalë dhe të pagave, kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit kontabël, vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit, vlerësimet dhe zbatimit të procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare, analiza financiare dhe këshillime përkatëse, si dhe shërbime të tjera të ngjashme;
 - është angazhuar në mësimdhënie në fushat e kontabilitetit;
 - është angazhuar si personel në ekipet e angazhimeve në auditimet ligjore të shoqërive;
 - ka kryer trajnime në fushën e kontabilitetit dhe çështje të lidhura me të, pranë një organizate në të cilën ka qenë anëtare, ose pranë IEKA-s;
 - ka marrë pjesë në konferenca/ëebinar-e të:
 - BMP-së;
 - institucioneve homologe të IFIAR;
 - një organizate profesionale anëtare të IFAC;
 - Bankës Botërore;
 - Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

për çështje të lidhura me fushën. Për këto do përdoren si referencë programet e trajnimit, çdo komunikim elektronik apo postar, apo çdo vërtetim/dëshmi tjetër të lëshuar nga institucioni përkatës.

- d. KM ka të drejtë të ankimojë pranë Sekretariatit Mbikëqyrës vendimin e Organizatës Profesionale për njohjen e orëve, duke përcjellë edhe evidencat/dokumentacionin mbështetës. Në rast se evidencat/dokumentacioni i dorëzuar nga KM që ka ankimuar vendimin për njohjen e orëve provon kryerjen e tyre, Sekretariati Mbikëqyrës ka të drejtë të bëjë njohjen e orëve dhe vendimi i përcillet Organizatës Profesionale.
4. Testimi do të zhvillohet brenda datës 30 Shtator 2021.
5. Tarifa për regjistrimin në testimin e edukimit të vijueshëm do të jetë 5,000 lekë për modul, ndërsa tarifa për procesin e njohjes së orëve sipas pikës 3/c të këtij neni, do të jetë 2.500 lekë. Në rast të njohjes së orëve sipas pikës 3/c të këtij neni dhe mospërmbushjes ende të orëve totale të detyrueshme për edukimin e vijueshëm, KM do ti nënshtrohet testimit sipas kategorizimit të fashave në pikën 3 të këtij neni, duke paguar diferencën midis tarifës për regjistrimin në testim dhe tarifës për procesin e njohjes së orëve. Tarifat do të administrohen nga Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar, në funksion të procesit të organizimit të testimit, në sallë ose online. 30 % e tarifës së regjistrimit në testimin e edukimit të vijueshëm që do ti nënshtrohet çdo subjekt KM dhe tarifës së procesit të njohjes së orëve që do të realizohet për çdo subjekt KM, do të transferohet nga Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar, brenda 30 ditësh nga arkëtimi, pranë llogarisë së BMP-së.

Neni 8

Hartimi i tezave, korrigjimi dhe ankimimi

1. Për hartimin dhe korrigjimin e tezave caktohen përkatësisht hartues dhe korrigjues, të cilët duhet të përmbushin kritere profesionale dhe të jenë të specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës. Organizata Profesionale përzgjedh hartuesit dhe korrigjuesit.
2. KM kanë të drejtë të ankohen me shkrim për rezultatin e testimit pas shpalljes së rezultatit pranë Sekretariatit Mbikëqyrës.

Neni 9

Mbikëqyrja e Testimit të Edukimit të Vijuëshëm

1. Testimi i parashikuar për përmbushjen e orëve të edukimit të vijuëshëm do të jetë objekt i kontrollit të cilësisë lidhur me procesin e hartimit dhe korrigjimit të tezave, përmbajtjen e tezave, procedurave të organizimit dhe kryerjes së këtyre testeve, verifikimin e konflikteve të interesit, shqyrtimin e ankesave sipas dispozitave të kësaj rregullore si dhe mbikëqyrjen e të gjitha procedurave dhe aktiviteteve të lidhura më këto teste.
2. Të gjitha fazat e organizimit dhe funksionimit të procesit të testimit të parashikuara do të mbikëqyren nga Sekretariati Mbikëqyrës dhe BMP sipas dispozitave të këtij vendimi.

Neni 10

Dispozitë Kalimtare

1. Kryerja me sukses e testimit sipas modulit nga ana e Kontabilistëve të Miratuar do të njihet si përmbushje e detyrimit të edukimit të vijuëshëm profesional për periudhën 2014-2019.
2. Organizatat profesionale duhet të hartojnë dhe miratojnë rregullat përkatëse mbi organizimin e procesit të testimit për përmbushjen e orëve të edukimit të vijuëshëm profesional për Kontabilistët e Miratuar, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij vendimi, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, brenda datës 31 Korrik 2021.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Dritan FINO



Anëtar

Adriana BERBERI

Adriana Berberi

Anëtar

Edlira LUÇI

()

Anëtar

Luan ABAZI

Luan Abazi

Anëtar

Klement MERSINI

Klement Mersini